



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.11.2018, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Prezantim nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë në Komisionin për Ekonominë dhe Financat i projektligjit “Për Buxhetin e vitit 2019”.
2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2017, për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive rurale”.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Ilir Xhakolli, Xhevit Bushaj, Arben Pëllumbi, Ervin Bushati, Reme Lala, dhe Roland Xhelilaj.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

1. Arben Ahmetaj - Ministër i Financave dhe Ekonomisë
2. Gelardina Prodani- Sekretare e Përgjithshme, Ministria Financave dhe Ekonomisë
3. Mimoza Dhembli - Drejtoreshë e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
4. Nikolla Lera - Drejtor i Përgjithshëm i Politikave Makroekonomike në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
5. Endrit Lami – Drejtor në Drejtorinë e Politikave Makroekonomike në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

6. Alba Caroshi – Këshilltare, Ministria e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Hapim mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit.

Në rendin e ditës së sotme të punës së këtij komisioni kemi dy çështje:

Së pari, prezantimin nga ministri i Financave dhe Ekonomisë të projektligjit “Për Buxhetin e vitit 2019”. Prezantimi i këtij projektbuxheti do të bëhet në parim. Siç e dini, shqyrtimi në këtë komision ka dy faza: së pari në parim dhe pas votimit në seancë plenare në datën 22 nëntor edhe shqyrtimin nën për nën i projektbuxhetit dhe i projektligjeve financiare që e shoqërojnë atë.

Sot do të bëhet njëherësh edhe relatimi nga ana e relatorëve të komisionit për buxhetin e shtetit për vitin 2019. Relatorë të komisionit për buxhetin janë zoti Anastas Angjeli dhe zonja Evis Kushi.

Pika e dytë e rendit të ditës është projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2017, për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive rurale”.

Për të prezantuar projektbuxhetin ndodhet në Komisionin e Ekonomisë zoti Arben Ahmetaj, ministër i Financave dhe Ekonomisë. Do të procedojmë me prezantimin e projektligjit respektiv nga ana e ministrit, më pas me relatorin e komisionit dhe më pas, në rast se do të duhet, pyetje, nëse ka, përgjigje dhe diskutime.

Fjalën është për ju.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit anëtarëve të komisionit!

Fjala ime është e shoqëruar dhe me një prezantim në monitor për të gjitha detajet e rëndësishme apo reformat. Më pas mund të ketë edhe pyetje dhe komente.

Projektbuxheti i vitit 2019, që ju është vënë në dispozicion për shqyrtim, vijon të mbështesë rritjen ekonomike të vendit ndërkohë që vijon konsolidimin fiskal duke ulur më tej barrën e borxhit publik për biznesin dhe qytetarët.

Rritja ekonomike për vitin 2019 parashikohet të jetë në nivelin 4,3% dhe pritet të forcohet më tej në vitet 2020 dhe 2021. Raporti i borxhit publik ndaj prodhimit të brendshëm bruto do të ulet në 66,9% në fund të vitit 2018, duke iu referuar borxhit neto, dhe në 64,9% në vitin 2019, duke synuar në 60% të prodhimit të brendshëm bruto në vitin 2021.

Rritja domethënëse ekonomike, e parashikuar për vitin 2019, krijon më shumë punësim me hapjen e mbi 30 mijë vendeve të reja pune të planifikuara, duke rezultuar në rënien e nivelit të papunësisë të forcës aktive për punë nën 12% në vitin 2019, krahasuar me 12,9% që planifikohet mesatarja e këtij viti. Në këtë kontekst, projektbuxheti i vitit 2019 do të vijojë të mbështesë krijimin e vendeve të reja të punës me politika incentivuese fiskale, si dhe me një skemë më efektive të punësimit dhe aftësimin profesional.

Rritja ekonomike pritet të mbështetet kryesisht nga kërkesa e brendshme, si konsumi privat dhe investimet. Ndërkohë, kërkesa e huaj neto (eksport – import) pritet të sjellë, gjithashtu, një efekt pozitiv, por akoma marxhinal. Konsumi privat pritet të nxitet kryesisht nga përmirësimi i besimit të konsumatorit, si dhe nga përmirësimi i tregut të punës. Ndërsa rritja e investimeve pritet të nxitet nga shfrytëzimi më i intensifikuar i kapaciteteve ekzistuese të prodhimit, si dhe nga përshpejtimi i aktivitetit ekonomik gjatë periudhës së parashikuar dhe perceptimi i përmirësuar i biznesit mbi perspektivën ekonomike afatmesme dhe afatgjatë të vendit. Njëkohësisht, vijimësia e përmirësimit të kushteve financiare dhe lehtësimit të standardeve të huadhënies pritet të jetë një faktor incentivues i investimeve private në afatmesëm.

Politika fiskale do të vazhdojë drejt konsolidimit në periudhën afatmesme e rrjedhimisht me efekt direkt neutral mbi konsumin. Por politika buxhetore e sigurimit të një niveli prej 5% të prodhimit të brendshëm bruto të investimeve publike do të mbështesë krijimin e konsiderueshëm të kapitalit fiks bruto në ekonomi, e cila është e rëndësishme për të mbajtur nivele relativisht të larta rritjeje, si në afatin e shkurtër, ashtu edhe në afatin e mesëm dhe të gjatë. Në të njëjtën kohë, qëndrimi akomodues i parashikuar i politikës monetare për periudhën afatmesme, për sa kohë që presionet inflacioniste do të mbeten në kahun e poshtëm, pritet të mbështesë gjithashtu konsumin privat dhe investimet.

Efekt i tjetër indirekt që vjen prej konsolidimit të stabilitetit makroekonomik dhe besimit të agjentëve në ekonominë e vendit, reduktimit të primeve të riskut, si dhe krijimit të një hapësire më të madhe për financim dhe zgjerimin e sektorit privat, padyshim që është një efekt tjetër pozitiv në performancën e ekonomisë në tërësi.

Rritja në periudhën afatmesme pritet të jetë e orientuar drejt krijimit të vendeve të punës krahasuar me historikun, pasi sektorët e prodhimit më intensiv të forcës së punës pritet të performojnë relativisht më mirë se të tjerët. Shkalla e papunësisë përllogaritet të zbrësë nën 12 % për vitin 2019 dhe të vazhdojë gradualisht rënien në vitet në vijim, për të shkuar drejt nivelit njëshifror.

Për sa i përket objektivit madhor, të konsolidimit fiskal, dëshiroj të sjell në vëmendjen tuaj disa aspekte kyçe që mbart projektbuxheti i vitit 2019: një deficit fiskal që, për herë të parë, programohet nën 2% të prodhimit të brendshëm bruto, pra 1,9%, ndërkohë që në periudhën afatmesme pritet të ulet edhe më shumë, deri në 1,2% të prodhimit të brendshëm bruto në vitin 2021.

Balanca primare, që për të katërtin vit radhazi është pozitive, shënon suficit 0,5% të prodhimit të brendshëm bruto në vitin 2019, i cili pritet të jetë edhe më i lartë në vitet pasuese.

Bilanci korrent me suficit të konsiderueshëm prej mbi 3% të prodhimit të brendshëm bruto në periudhën 2019-2021, i cili përkthehet në një përgjegjshmëri të lartë të qeverisë, financon tërësisht operacionet e saj nga të ardhurat buxhetore dhe financim të investimeve publike me një shifër të konsiderueshme nga të ardhurat buxhetore me mbi 3% të prodhimit të brendshëm bruto, ndërkohë që pjesa tjetër do të financohet nëpërmjet huave. Ky është edhe rregulli i artë, që i referohet edhe bilancit korrent që tregon pozitivitet në qasjen e buxhetit 2019, si dhe përgjegjshmërinë e qeverisë në menaxhimin e financave publike. Për rrjedhojë niveli i borxhit publik do të vijojë të ulet gjithnjë e më shumë në nivele më të sigurt dhe gjithnjë e më pak të kushtueshme për ekonominë dhe qytetarët.

Të ardhurat buxhetore për vitin 2019 janë parashikuar duke marrë parasysh faktorë të tillë, si: rritja ekonomike dhe indeksi i çmimeve, politikat e reja fiskale, si dhe efektet nga lufta kundër informalitetit, e shoqëruar kjo me masa ligjore antishmangieje, me qëllim rritjen e nivelit të pajtimit vullnetar të tatimpaguesve me ligjin. Të ardhurat buxhetore në fund të vitit 2018 priten të jenë 458,2 miliardë lekë. Krahasuar me vitin 2017, parashikohet një rritje prej 6,5% ose 27,8 miliardë lekësh, duke kapur nivelin 27,8% të prodhimit të brendshëm bruto, nga 27,7% që ishin në vitin 2017. Rritja me 0,1% e kontributit të të ardhurave të buxhetit të shtetit, në raport me produktin e brendshëm bruto për vitin 2018, është tregues i rëndësishëm i përmirësimit të performancës së mbledhjes së të ardhurave në kuadër të reformës së konsolidimit të financave publike. Kjo rritje vjen kryesisht si rrjedhojë e rritjes ekonomike dhe nga përmirësimi në administrimin e taksave, pavarësisht efekteve negative të kursit të këmbimit në të ardhurat nga importi.

Dëshiroj të ilustroj këtu vetëm efektin negativ që ka pasur kursi i ulët i këmbimit euro/lekë në të ardhurat e pritshme nga TVSH-ja, ku për 9-mujorin e vitit 2018 përlllogaritet një vlerë e konsiderueshme prej 6 miliardë lekësh më pak, ndërkohë që prognoza deri në fund të vitit shkon në 9 miliardë lekë.

Paketa fiskale për vitin 2019 synon arritjen e disa objektivave, si: uljen e barrës tatimore për grupe të caktuara individësh, siç janë të punësuarit me nivel të mesëm pagash; uljen e barrës së kombinuar fiskale mbi fitimin dhe dividendin për kompanitë; dhënien e incentivave dhe stimujve tatimorë për industri dhe sektorë të caktuar, si: bujqësia, fasoni, farmaceutika; stimulimi i politikave në transport, në funksion të mbrojtjes së ambientit (me TVSH-në e reduktuar për autobuzët, për transportin publik nga 20% në 10%), si dhe rregullime të barrës fiskale në fushën e mallrave të akcizës.

Paketa fiskale për vitin 2019 parashikon ndryshimet e mëposhtme.

Referuar ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, norma e tatimit mbi dividendin ulet nga 15% në 8%; kufiri i pagës që tatohet rritet me 23 %, nga 130 mijë lekë në 150 mijë lekë; vihet një dispozitë taksimi për fitimet kapitale jorezidente, në lidhje me shitjet e kuotave të kompanive apo aktiveve që ndodhen në Shqipëri. Kjo është një masë antievazion, në harmoni të plotë me zhvillimet e fundit që ka avancuar OECD-ja.

Referuar ligjit “Për taksat nacionale”, do të kemi kalimin e taksimit të ambalazheve plastike tek taksimi i materialeve plastike, pra zgjerim të bazës; uljen e taksës me dy të tretat, po ashtu uljen me 50 % të masës së taksës për ambalazhet e qelqit; rritjen e rentës minerare për eksportin e kromit nga 6% në 9%, me qëllim për të mbrojtur rezervën e njohur, e cila, me hapat që po eksportohet, praktikisht me referencë të 600 mijë tonësh të eksportuar në vit, presupozohet të mbarojë për tetë vjet. Sigurisht, rezervat e kromit janë shumë e më shumë sesa rezervat e njohura, por këtu po bëjmë një ekuilibrim ndërmjet eksportit dhe vlerës së shtuar brenda vendit.

Referuar ligjit “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, do të kemi përjashtimin në import të lëndëve të para për fabrikat e prodhimit farmaceutik, në linjë me atë që kemi kaluar disa vite në parlament, pra uljen e TVSH-së, zerimin për medikamentet; përjashtimin nga TVSH-ja të furnizimit me shërbim nga nënkontraktorët për kontraktorët në industrinë fason; përjashtimin nga TVSH-ja të importit të makinerive bujqësore, sipas listës së miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, nga çdo importues; reduktimin e normës së TVSH-së me 10% për importin e autobuzëve elektrikë të transportit publik, si dhe reduktimin e normës me 6% për shërbimin e reklamave nga televizionet, nga i përjashtuar, siç ka qenë deri tani.

Referuar ligjit “Për akcizat”, kemi vendosjen e akcizës 1 lekë/kg për zhavorin bituminoz, që përdoret si lëndë djegëse alternative; heqjen e akcizës për fishekzjarrët, llambat, pilat/bateritë, e sugjeruar edhe nga Fondi Monetar Ndërkombëtar disa herë; rritjen e akcizës për duhanin e përpunuar dhe zëvendësuesit e tij, duhanet me ngrohje, purot.

Referuar ligjit “Për procedurat tatimore”, do të kemi dispozitë të përgjithshme antishmangie nga taksat, në përputhje me direktivën respektive të Bashkimit Europian; dispozitë antishmangie në lidhje me regjistrimin e më shumë se një biznesi nga personat fizikë tregtarë, si dhe lehtësimin e procedurave të çregjistrimit të biznesit.

Shpenzimet buxhetore për vitin 2019 do të vijojnë të mbështesin sektorët prioritarë, si: arsimi, shëndetësia, bujqësia, infrastruktura, të cilët do të stimulojnë më tej rritjen ekonomike të vendit, duke gjeneruar njëkohësisht edhe punësimin. Gjithashtu, mbështeten një sërë reformash, duke filluar nga ajo e drejtësisë deri te reforma e ujit.

Për vitin 2019 shpenzimet buxhetore do të kapin për herë të parë vlerën absolute prej 519,4 miliardë lekësh ose 29,6% të prodhimit të brendshëm bruto. Krahasuar me të pritshmin e vitit 2018, totali i shpenzimeve buxhetore programohet me rritje prej 5,9% më shumë.

Shpenzimet e personelit, të planifikuara në masën 80,6 miliardë lekë për vitin 2019, përveç financimit të plotë të kostos aktuale të administratës publike qendrore, mbartin dhe reflektojnë gjithashtu edhe politikat e rritjes së pagave për sektorin e shëndetësisë (7%), të arsimit (7%), të mbrojtjes në minimum (7%), por mund të shkojë edhe (10%), sistemit penitenciar (7%) dhe punonjësit e përfaqësive diplomatike (20% ose mbi 20%). Krahas kësaj në këto shpenzime planifikohet kostoja e plotë e reformës në drejtësi, për akomodimin e pagave të reja të institucioneve aktuale të sistemit të drejtësisë, si dhe akomodimi i institucioneve të reja të krijuara për mbështetjen e kësaj reforme, siç janë SPAK-u dhe Byroja Kombëtare e Hetimit.

Vlen të theksohet se nga kjo rritje e konsiderueshme e pagave përfitojnë: 4,650 mjekë; 13,765 ndihmësmjekë/infermierë; 35,783 mësues; 6,800 ushtarakë; 3,559 efektivë të Policisë së Burgjeve, si dhe 308 diplomatë.

Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes do të kapin vlerën 48,6 miliardë lekë, duke prioritzuar mbështetjen e skemës së fermerëve me një rritje në dy vjetët e fundit në 2,6 miliardë lekë.

Viti 2019 mund të konsiderohet edhe, ndër të tjera, viti i rritjes së pagave; viti i mbështetjes së bujqësisë, pra do të jetë një nga sektorët më të financuar; patjetër edhe si viti i paketës sociale.

Ndërkohë, mirëmbajtja e rrugëve do të jetë një fokus i rëndësishëm brenda financimit të infrastrukturës. Ky është viti i dytë ku do të kemi shumë të strukturuar ndërmjet Bankës Botërore dhe burimeve të brendshme të konsiderueshme për mirëmbajtjen e rrugëve, si dhe mirëmbajtjen e sistemeve të teknologjisë së informacionit në administratën publike.

Shpenzimet për interesa planifikohen në vlerën 41,7 miliardë lekë ose 2,4% të prodhimit të brendshëm bruto për të përballuar një rritje të mundshme të normave të interesit 1 deri në 2 pikë përqindje, duke iu referuar edhe sinjaleve të fundit qoftë nga Banka Qendrore Europiane, qoftë nga Banka Qendrore Amerikane (Federal Reserve).

Subvencionet parashikohen me ulje në terma absolutë dhe relativë, krahasuar me një vit më parë, ku planifikohen rreth 1,5 miliardë lekë ose 0,1% e prodhimit të brendshëm bruto. Kjo ulje vjen si pasojë e rialokimit të një pjese të mirë të subvencionit të parashikuar për ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve tek investimet publike në rehabilitimin dhe ndërtimin e rrjeteve të ujësjellës-kanalizimeve, në kuadër të përshpejtimit të reformës së ndërmarrë nga qeveria për këtë sektor jetik, që do të thotë se subvencioni nuk do të jetë më një subvencion pasiv dhe të financojë kostot, por do të financojë investimet.

Shpenzimet e fondeve speciale, që përfshijnë shpenzimet totale për fondet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe kompensimin në vlerë të ish-pronarëve, janë planifikuar në vlerën prej 179,98 miliardë lekë për vitin 2019.

Dua t'ju tërheq këtu vëmendjen te një fakt mjaft pozitiv dhe interesant për sa i përket fondit të kompensimit të ish-pronarëve. Për herë të parë në buxhetin e vitit 2019 jo vetëm që do të jetë një shumë 5 miliardë e nominuar, në bazë të ligjit që kemi hartuar për trajtimin e ish-pronarëve me kompensim qoftë fizik, qoftë monetar, shuma prej 5 miliardësh nuk do të jetë në fund të vitit, pra të periudhës fiskale, objekt i deficitit buxhetor. Kjo do të thotë që shuma prej 5 miliardësh nuk do të jetë harxhuar plotësisht, por do të transferohet, pra si mbetje, për vitin pasardhës, në mënyrë që fondi për kompensimin e ish-pronarëve të mos preket, duke iu referuar ligjit që kemi miratuar në parlament.

Skema e sigurimeve shoqërore, niveli i shpenzimeve për skemën e sigurimeve shoqërore për vitin 2019 parashikohet në masën 130,63 miliardë lekë ose 7,5% e prodhimit të brendshëm bruto. Ky raport është i njëjtë me vitin 2018, nga i cili për indeksimin e pensioneve është parashikuar një fond prej gati 2,45 miliardë lekësh. Duhet theksuar këtu se, krahasuar me vitin 2013, skema e pensioneve i rëndon më pak buxhetit të shtetit, pasi në vitin 2013 transferta buxhetore zinte rreth 46,2% të totalit të shpenzimeve, ndërkohë që për vitin 2019 parashikohet të zërë 35,6% të totalit; përmirësim i ndjeshëm. Kjo ka ardhur si pasojë e dy faktorëve kryesorë: (i) uljes së nivelit të informalitetit në tregun e punës dhe (ii) rritjes së nivelit të punësimit dhe kontribuuesve.

Skema e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2019 është parashikuar në masën 41,9 miliardë lekë ose 2,4% të prodhimit të brendshëm bruto, nga 40,4 miliardë lekë në vitin 2018.

Fondi për kompensimin në vlerë të pronarëve parashikohet, siç e theksova më lart, në total në masën 5 miliardë lekë ose 0,3% të prodhimit të brendshëm bruto. Duke filluar nga viti 2016 fondi i kompensimit është planifikuar në rritje nga viti në vit, duke synuar në vitin 2021 shumën 5,5 miliardë lekë krahasuar me 1,89 miliardë lekë, që ishte në vitin 2013.

Me këto shifra, të nderuar anëtarë të komisionit, bie edhe miti i opozitës dhe del në pah e vërteta qoftë statistikore, qoftë emocionale se si janë trajtuar ish-pronarët në vite. Rritja e fondit të kompensimit në vlerë të pronarëve bëhet në mbështetje të reformës së ndërmarrë nga kjo qeveri (siç e theksova më lart), për trajtimin e ish-pronarëve pjesë e së cilës është kompensimi në vlerë për t'u realizuar brenda periudhës 10-vjeçare të parashikuar në ligjin nr. 133/2015 "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave".

U bëj thirrje pronarëve të ligjshëm, që trajtohen me këtë ligj se shifra që ne sjellim në buxhet e largon debatin politik nga tryezat, nga mendjet dhe nga shtëpitë e tyre dhe tregon të vërtetën se si kjo maxhorancë jo vetëm ka mbajtur një qasje tejet të vëmendshme, por nëpërmjet një ligji tejet të kujdesshëm dhe një alokimi të rëndësishëm në buxhet të zgjidhë një herë e mirë problemin e kompensimit fizik dhe monetar të pronës.

Shpenzimet e tjera sociale që përfshijnë:

- Shpenzimet për pagesën e papunësisë parashikohen në nivelin 500 milionë lekë.
- - Shpenzimet për pagesën e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar parashikohen në nivelin 20,5 miliardë lekë dhe janë në të njëjtin nivel si vitin e kaluar.
- - Për ish-të përndjekurit është parashikuar një fond prej 1 miliard lekësh ose 0,1% të PBB-së.
- Për bonusin e lindjeve është parashikuar një fond prej 2 miliardë lekësh. Nga kjo politikë e re pritet të përfitojnë rreth 30 mijë familje gjatë vitit 2019. Ky është dhe një nga reagimet e para që ka një qeveri në këta 27 vjet, për sa i përket riskut të uljes së ritmit të lindjeve, pra riskut demografik.

Niveli i fondit rezervë për vitin 2019 planifikohet në masën 3 miliardë lekë, përkatësisht 1,5 miliardë lekë për fondin rezervë i Këshillit të Ministrave dhe 1,5 miliardë lekë fond kontigjence për financimin e pagave të reja për magjistratin dhe për ngritjen dhe funksionimin e institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë, midis tyre Byroja Kombëtare e Hetimit dhe SPAK-u.

Investimet Publike për vitin 2019 janë planifikuar në masën 5,1% të PBB-së ose 88,8 miliardë lekë (përfshirë dhe mbështetjen për sektorin e energjisë 3 miliardë lekë në

formën e investimeve të huaja), apo siç i referohemi teknikisht pozicionit neto të sektorit të energjisë, reflektuar 2 vjet më parë brenda deficitit buxhetor.

Për sa i përket mbështetjes së sektorëve prioritarë, dëshiroj ta filloj me arsimin ku synojmë të mbajmë të njëjtin nivel konstant në raport me PBB-në prej 3% përgjatë periudhës 2019-2021.

Përveç rritjes së pagave të parashikuar për mësuesit në vitin 2019, në këtë sektor do të financohet me përparësi:

- Ofrimi i teksteve shkollore falas për 190 mijë nxënës të arsimit parauniversitar, nga të cilët 125 mijë janë nxënës të klasave I-IV. Kostoja vjetore do të jetë nga 610 - 700 milionë lekë në vit.

Transporti është siguruar për 28 mijë nxënës, që kanë vendbanimin mbi 2 km nga shkolla, si dhe për 10 mijë mësues, që punojnë mbi 5 km nga vendbanimi/qendra e përhershme e punës në shkollë. Kostoja vjetore shkon rreth 680 milionë lekë në vit.

Për 1000-1400 nxënës të arsimit parauniversitar nga shtresat sociale në nevojë, do të garantohet trajtimi me kuotë ushqimore.

Për arsimin bazë: ndërtime të reja dhe shtesa objektesh (janë 15-20 objekte shkollore) në vlerën 800 milionë lekë (400 milionë lekë do të jenë në vitin e ardhshëm).

- Rikonstruksione (90-100 objekte shkollore) me një vlerë rreth 5 miliardë lekë (1,25 miliard lekë vetëm në vitin 2019)

Për arsimin e mesëm të përgjithshëm: ndërtime të reja dhe shtesa objektesh (6-10 objekte shkollore) në vlerën rreth 660 milionë lekë (300 milionë lekë në vitin 2019);

Rikonstruksione (30-40 objekte shkollore) me një vlerë rreth 1,5 miliardë lekë (750 milionë lekë do të jenë vetëm për vitin 2019)

Dua të ritheksoj rritjen e pagave në sistemin e arsimit, ku do të përfitojnë 35783 mësues. Është hera e dytë radhazi që arsimi ka një rritje të konsiderueshme.

Dua t'ju kujtoj vitin 2017 në të cilin janë rritur konsiderueshëm pagat, ku përfituan konsiderueshëm edhe punonjësit e arsimit. Siç e theksova, përfitojnë 35783 mësues. Kjo është rritja e dytë e konsiderueshme brenda një periudhe shumë të shkurtër, në harmoni të plotë me objektivin e qeverisë për të mirëfinacuar të gjithë trupën e mësuesve dhe me theksin tek arsimi në tërësi.

Për shëndetësinë financimi do të mbetet në nivelet 2,9 % mesatarisht për periudhën 2019-2021, ku vlen të theksohet se rritja së pagave për 4600 mjekë dhe për mbi 13 000 infermierë. Kjo është rritja e dytë e konsiderueshme për këtë sektor. Rritja e parë që ka qenë në vitin 2017, do të vazhdojë me të njëjtën logjikë si arsimi.

Objektivat e shëndetësisë janë:

- Reduktimi në më pak se 15 % i numrit të pacientëve të rishtruar për të njëjtën diagnozë brenda 72 orësh nëpërmjet urgjencës;
- Reduktimi i kohës së pritjes për ekzaminime të rëndësishme (rezonancë magnetike-skaner), në më pak se 45 ditë;
- Reduktimi i indeksit të vdekshmërisë foshnjore për periudhën 2019-2021;
- Garantimi i mbulesës vaksinale;
- 200 qendra shëndetësore të rikonstruara dhe të pajisura, nga 100 në çdo vit për periudhën 2019-2020;

Mos harroni që këtë vit mbaron rikonstrukcioni i plotë i 80 qendrave shëndetësore në të gjithë vendin.

Lidhur me skemën e rimbursimit të barnave, kemi konstatuar se kjo skemë po ecën përtej mundësive që parashikon buxheti, dhe logjikës së mirëadministrimit të kësaj pjese me një rritje prej 23, 6 % për periudhën 2019-2021 dhe kësisoj, ka nevojë për një reformë që sjell eficiencë dhe efektivitet më të lartë të kësaj skeme.

Për këtë qëllim, në nenin 5 të projektligjit për buxhetin e vitit 2019, që përcakton buxhetin e FSDKSH-së, kemi propozuar vënien e një tavani shpenzimesh për këtë skemë me vlerën 10,5 miliardë lekë, për të incentivuar më tej ndërmarrjen e kësaj reforme tejet të domosdoshme.

Bujqësia siç e thashë, do të vazhdojë të përfitojë në terma reale 0,6 % të prodhimit të brendshëm bruto për periudhën 2019-2021 nga buxheti i shtetit. Siç e theksova, bujqësia do të jetë një nga sektorët potencialë më të financuar për vitin 2019. Cilat janë arsyt pse unë e theksoj këtë?

Së pari, që nga viti 2018 mbështetja për fermerët është rritur në 2,6 miliardë lekë, pra ka pasur 900 milionë lekë më shumë nga viti në vit. Nga 1,8 miliardë lekë, që ishin në vitin 2017 në 2,6 miliardë lekë, në vitin 2018 dhe do të vazhdojë të jetë kështu me këtë shifër.

E dyta, që është shumë e rëndësishme, është fillimi i IPARD-it, i cili në logjikën e vet ka kombinimin e financimit 25% nga buxheti i shtetit dhe 75% nga IPARD-i.

Ne kemi vendosur në buxhetin e shtetit, në funksion të avancimit të IPARD-it 1 miliard lekë, që do të thotë se me eficiencën që duhet të ketë AZHBR-ja dhe Ministria e Bujqësisë, ka mundësi të tërheqë 40 milionë euro investime në sektor. Pra, përveç 2,6 miliardëve që do të jetë një injektim i drejtpërdrejtë nga buxheti i shtetit, kombinimi midis

këtyre financimeve bëjnë 40 milionë dollarë, të cilët kanë potencialin të shkojnë në sektorin e bujqësisë.

Përveç kësaj vazhdojmë të financojmë fondin e garancisë me BERZH-in, në mënyrë që në terrenin ekonomik agrobujqësor të përfitohet më shumë kredi e butë, e mbështetur me kolateral nga fondi i garancisë dhe me interesa të subvencionuara, që do të thotë që sektori i bujqësisë ka mundësi të tërheqë fonde rekord në krahasim me çdo periudhë tjetër.

Infrastruktura do të përfitojë fonde të konsiderueshme përgjatë periudhës 2019-2021, rreth 2,8 % të prodhimit të brendshëm bruto, ku synohet:

- Kompletimi i akseve rrugore nacionale si: Rruga e Arbrit; Thumanë-Vorë-Kashar, Milot-Balldren; Orikum-Dukat, brenda vitit 2021 me projektin “1 Miliard”. Siç e dini Rruga e Arbrit ka filluar dhe është në një fazë të avancuar të punëve në terren.

Ndërkohë, po përgatitet procedura për aksin Tiranë-Durrës me zgjerimin me 3 korsi, pra në total 6 korsi për këtë aks kryesor të vendit (Tiranë-Durrës) dhe vazhdimin e përmirësimit më tej, nëpërmjet një aksi të ri, Vorë-Rrogozhinë.

Dua të theksoj se projekti i paraqitur zyrtarisht në Ministrinë e Infrastrukturës është shpërndarë në autoritetet që marrin pjesë në konsiderimin e projektit, duke përfshirë edhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Ky është një propozim, i cili kërkon zero lekë nga buxheti i shtetit. Pra, do të jetë një PPP, i cili do të financohet tërësisht nga investitorët dhe në afat të gjatë, rikthimi i investimit do të vijë nga financimi nëpërmjet *toll-it* qoftë për operacionet, qoftë për mirëmbajtjen, qoftë për investimet, nëse do të plotësohen të gjitha kushtet.

Kompletimi i pjesës dërmuese të segmenteve rrugore në vazhdim me financim të brendshëm gjatë vitit 2021, për aksin Kardhiq - Delvinë, që është një aks jetik për turizmin dhe për rritjen e konektivitetit në Rajonin e Jugut. Ai e shkurton kohën e rrugëtimit Tiranë - Sarandë me rreth 1 orë. Sigurisht, ajo që është një nga objektivat kryesore, rrit cilësinë e konektivitetit dhe përmirëson cilësinë e rrjetit rrugor, që sjell uljen e aksidenteve.

Ndërkohë, vazhdon financimi i akseve: Elbasan-Banjë; *By pass-i* i Shkodrës; *By pass-i* i Tepelenës dhe një pjesë e mirë e Unazës së Tiranës;

- Kompletimi i segmenteve rrugore brenda vitit 2021 me financim të huaj, si *By pass-i* i Fierit, që mendohet të bëhet i kalueshëm përpara hapjes së sezonit turistik veror të vitit 2019; *By pass-i* i Vlorës dhe aksi Qukës-Qafë Plloçë;

- Në mars 2019 bëhet i plotë dhe i kalueshëm loti i fundit, aksi Tiranë-Elbasan.

- Një tjetër objektiv është edhe vënia në funksion e aeroportit të Vlorës dhe atij të Kukësit nëpërmjet skemave të partneritetit publik privat;

- - Furnizimi për 24 orë me ujë dhe shërbime për zonën bregdetare brenda vitit 2021;

- - Në vitin 2020 parashikohet të rritet përdorimi i energjisë së rinovueshme me 38%, ndërsa në vitin 2021 synohet të riciklohet rreth 20 % e totalit të mbetjeve të prodhuara nga 0,05% që parashikohet në vitin 2018.

Për të tretin vit radhazi shpenzimet për buxhetin vendor do të vazhdojnë të mbështesin reformën administrative territoriale dhe reformën e decentralizimit.

Në projektbuxhetin e vitit 2019, burimet e financimit të vetëqeverisjes vendore do të rriten me rreth 5 miliardë lekë ose 11 % më shumë sesa ato të vitit 2018, të cilat do të shkojnë për më shumë investime dhe përmirësime të shërbimeve publike. Ndër masat më të rëndësishme përmendim miratimin dhe zbatimin e ligjit të vetëqeverisjes vendore dhe reformën për taksën e ndërtesave, me ngritjen e strukturave të posaçme dhe krijimin e kadastrës fiskale.

Për informacion, sot prezantohet me pushtetin vendor edhe platforma e kadastrës fiskale, ku do t'u kërkohej njësive vendore të fillojnë ta përditësojnë me informacion, gjë që e kanë edhe detyrim ligjor. Unë kisha edhe një diskutim të gjatë dhe të frytshëm me qeverisjen vendore, ku prezantua buxhetin dhe shkëmbyem mendime me palët. Transferta prej 1 % e prodhimit të brendshëm bruto është vendosur në ligj dhe ne e kemi të pacenuar si angazhim dhe si shumë në buxhetin e vitit 2019.

Shpenzimet e buxhetit vendor për vitin 2019 janë parashikuar në masën 51,14 miliardë lekë, të cilat zënë 2,9% të prodhimit të brendshëm bruto, nga 2,3% që zinin në vitin 2013. Pjesa më e madhe, mbi 60% e këtyre shpenzimeve, shkojnë për investime dhe shërbime publike për komunitetet vendore.

Burimi i zgjerimit të shpenzimeve vendore për vitin 2019 është rritja e të ardhurave nga taksat dhe tarifat e veta, si dhe nga rritja e transfertës të pakushtëzuar të përgjithshme.

Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2019 parashikohen të kenë një rritje me mbi 3,8 miliardë lekë më shumë sesa plani i vitit 2018, ose e thënë ndryshe, me një rritje prej rreth 21 %. Ndërkohë, krahasuar me vitin 2015, të ardhurat vendore parashikohen me një rritje të konsiderueshme me rreth 90 %. Po t'i kthehemi sot, jo vetëm për statistika, por edhe për reflektim, të gjithë reformës dhe politikës për sa i përket decentralizimit dhe reformës administrative, më duhet të them pa ndrojtje që ka qenë një vizion shumë i qartë dhe një sukses i plotë në favor të komuniteteve vendore. Kjo rritje e nivelit të të ardhurave do të

vazhdojë si rrjedhojë e ndarjes më të drejtë dhe transparente të financave për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe përmirësimit të vazhdueshëm të skemës së financimit të funksioneve të veta, si dhe rritjes së burimeve të financimit të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Gjithashtu, reforma që ka filluar në taksën e pronës, konkretisht për taksën mbi ndërtesat dhe ngritjen e kadastrës fiskale, parashikohet të ndikojë ndjeshëm në rritjen e të ardhurave në buxhetin vendor për vitin 2019 dhe për vitet e tjera në vazhdim.

Në buxhetin vendor të vitit 2019, në vijim të reformës administrative territoriale dhe decentralizimit, vend të rëndësishëm zë reforma e financimit të arsimit parashkollor.

Për vitin 2019, fondet për pagat e edukatorëve do të rriten me 9,1 % në krahasim edhe me vitin 2018. Në të njëjtën kohë do të përmirësohet sistemi i ndarjes së fondeve ndërmjet bashkive. Në ndryshim nga sistemi i mëparshëm, ku fondet ndaheshin sipas numrit të edukatorëve, tashmë konform praktikave më të mira ndërkombëtare, financimi i këtij funksioni në vitin 2019 do të bazohet kryesisht në numrin e nxënësve dhe fëmijëve 3-6 vjeç, si një kriter më objektiv për përcaktimin e nevojave për shpenzime. Nëse deri dje merrnim si bazë numrin e edukatorëve, sot e kemi përmbysur në favor të reflektimit të numrit të nxënësve për t'u shërbyer. Kështu, 60 % e transfertës për arsimin parashkollor do të ndahet bazuar në numrin e fëmijëve 3-6 vjeç dhe 40 % do të vazhdojë të ndahet mbi numrin e edukatorëve, pra një kombinim, sepse është periudhë tranzitore. Nga kjo reformë, në buxhetin e vitit 2019 nuk do të ketë asnjë bashki që humbet fonde, përkundrazi, pjesa më e madhe e bashkive do të jetë fituese në fonde për këtë shërbim. Si rrjedhojë e kësaj reforme do të punësohen 438 edukatorë më shumë sesa në vitin 2018. Kjo reformë do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në uljen e madhësisë maksimale mesatare të grupeve në kopshte nga 26 në 18 nxënës për edukator dhe të madhësisë mesatare kombëtare nga 18 në 15 nxënës për edukator.

Buxheti vendor i vitit 2019 do të jetë buxheti me të cilin gjen zbatim të plotë ligji për financat e vetëqeverisjes vendore, ku jo vetëm ka fonde më shumë sesa vitet e mëparshme, por ka edhe një kuadër tashmë të plotë procedurash, rregullash dhe kriteresh të menaxhimit financiar vendor, çka garanton efektivitet dhe eficiencë në përdorimin e parasë publike në nivel vendor.

Dua të theksoj, ashtu sikur e theksova në takimin që kisha me pushtetin vendor, për sa u përket detyrimeve të prapambetura të pushtetit vendor, e bëmë shumë të qartë që pushteti qendror nuk do të marrë përsipër dhe nuk dua të paguajë borxhet e pushtetit vendor, përkundrazi, pushtetit vendor, në bazë të ligjit, i takon të jetë i përgjegjshëm dhe të shlyejë detyrimet e veta ndaj të tretëve, ashtu siç bën qeveria qendrore.

Së fundi, dua ta mbyll fjalën duke u ndalur në dy momente të rëndësishme, që kanë të bëjnë me risqet potenciale, që shoqërojnë buxhetin e vitit 2019 dhe mitigimin e tyre.

Së pari, lidhur me riskun e financimit të deficitit buxhetor dhe atij të refinancimit të borxhit publik, dua të nënvizoj se nevojat për hua kanë ardhur duke u ulur gradualisht, duke reflektuar përmirësimin e strukturës së borxhit dhe reduktimin e riskut fiskal të qeverisë. Në harkun kohor të 5 vjetëve, huamarrja në terma bruto është bazuar mesatarisht në rreth 85% në burimet e brendshme të financimit, ku si instrument huaje janë përdorur titujt shtetërorë. Në dy vjetët e fundit, 2017 – 2018 , ka pasur një rritje në favor të huamarrjes së huaj, kryesisht të realizuar në kuadër të shfrytëzimit të burimeve të favorshme të financimit të vëna në dispozicion nga institucionet financiare ndërkombëtare, si dhe shfrytëzimit të kushteve të favorshme të tregjeve ndërkombëtare në kuadër të mirëmanaxhimit të likuiditetit dhe detyrimeve të borxhit në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme. Fakt është ekspozimi shumë pozitiv që ekonomia shqiptare pati me procesin e fundit të eurobondit, ku arritëm të merrnim një rekord historik të ulët të çmim-kuponit, prej 3,5%. Ndërkohë, po t'i referohemi vitit 2015, çmim-kuponi ka qenë 5,75% dhe po të rikthehemi në vitin 2010, shkoi mbi 7,5%, ku për shkak të risqeve të rritura në një moment u kuotua me 13% interes.

Në drejtim të uljes së ekspozimit ndaj rritjeve ka ndikuar rritja e përqendrimit të huamarrjes së brendshme në titujt afatgjatë me norma interesi fikse. Në qoftë se nuk gabohem, shifra e maturimit të borxhit të brendshëm ka shkuar në 805 ditë nga 540 ditë që ka qenë disa vjet më parë, duke futur edhe borxhin e jashtëm praktikisht ka shkuar në 4,8 vjet maturim. Pra, balancimi i maturimit ka ardhur gjithmonë e në përmirësim. Ndërkohë, në drejtim të optimizimit të kostove të përgjithshme të huamarrjes, ka ndikuar rënia e normave të interesit, shoqëruar me përqendrimin e një pjesë të konsiderueshme të huamarrjes së huaj në burimet e financimit me natyrë dypalëshe dhe shumëpalëshe. Në këtë aspekt, vlen të përmendet se gjatë viteve të fundit jo vetëm kostot për njësi, por edhe kostot e përgjithshme të huamarrjes janë ulur ndjeshëm.

Së dyti, lidhur me risqet e tjera buxhetore, dua të theksoj se projektbuxheti i vitit 2019 vijon të mbajë rezerva konsistente në krahun e shpenzimeve buxhetore, në masën 0,7 % të totalit të shpenzimeve buxhetore të vitit 2019, ose rreth 4,3 miliardë lekë, të cilat, në vlerësimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, do të mund të absorbojnë mjaftueshëm probabilitetin e materializimit të risqeve, duke iu referuar goditjeve makroekonomike, realizimit më të ulët se parashikimi i të ardhurave buxhetore në potencë, kursit të pafavorshëm të këmbimit dhe normave të interesit më të larta se pritshmëria, që ndikojnë shpenzimet për shërbimin e borxhit publik.

Për sa ju përket risqeve buxhetore me natyrë implicite, do të rendisja sektorin elektroenergjetik, ku përmes ruajtjes së një rezultati neto synohet një risk i ulët i ekspozimit të buxhetit ndaj këtij sektori, pra pozicionimit neto të qëndrueshëm, siç iu referova më lart, i cili nuk rrezikon buxhetin për sektorët e tjerë prioritarë, pra, 3 miliardë lekë në vit, mbajtjes së një rezerve për përballimin e vulnerabilitetit ndaj kushteve meteorologjike, të paparashikuara 1 deri në 3 miliardë lekë në vit. Një risk implicit është ekspozimi i buxhetit ndaj pagesave të partneritetit publik privat aktiv, ku për vitin 2019 e në vijim ky ekspozim do të jetë dukshëm brenda limitit ligjor prej 5% të totalit të të ardhurave buxhetore të vitit paraardhës, duke mbajtur një trend të lehtë rritës nga 3% në vitin 2019, në 3,4% në vitin 2021. Kjo rrëzon çdo debat, çdo politizim dhe demonizimi që i bëhet partneriteti publik privat. Financimi i partneritetit publik privat në formulë të kombinuar do të jetë brenda limiteve ligjore të shkruara nominalisht në ligjin organik të buxhetit dhe nuk do ta arrijë kurrë 5%-in e totalit të të ardhurave tatimore të vitit paraardhës. Çdo lloj debati për procedurën dhe transparencën është i mirëpritur dhe vetëm përmirëson procesin. Debati fiskal mbaron këtu, nuk do të kalojë kurrë 5%-in! Në funksion të kombinimit të konsolidimit fiskal dhe investimeve të rëndësishme në infrastrukturën rrugore dhe jo vetëm, debati fiskal në vitin 2021 do të jetë shumë brenda 5%-it.

Detyrimet kontigjente, që kanë të bëjnë kryesisht me vendimet e gjykatave ndërkombëtare, Strasburgut dhe Arbitrazhit dhe të vendit, vendimet gjyqësore të formës së prerë, në buxhetin e vitit 2019 parashikohen të përballohen nëpërmjet përdorimit të fondit rezervë të Këshillit të Ministrave dhe buxheteve respektive të ministrive të linjës dhe institucioneve buxhetore të prekura nga këto vendime.

Risku tjetër është krijimi i detyrimeve të prapambetura, ku Ministria e Financave dhe Ekonomisë e ka intensifikuar rolin e saj monitorues dhe raportues, duke punuar fort për të informalizuar tërësisht procesin e menaxhimit të angazhimeve buxhetore nëpërmjet sistemit të ri të menaxhimit financiar AFMIS, i cili pritet të fillojë më 1 janar të vitit 2019 dhe të sjellë rezultate akoma më domethënëse në eliminimin apo minimizimin e rasteve të krijimit të detyrimeve të prapambetura të institucioneve buxhetore ndaj të tretëve.

Në përfundim, dua t'ju risjell në vëmendje objektivat madhorë që synon të realizojë qeveria shqiptare nëpërmjet projektbuxhetit 2019. Objektivi kryesor është, mbi të gjitha, ai i rritjes ekonomike, i forcimit të rritjes ekonomike të vendit dhe konsolidimit fiskal. E theksoj këtë, pasi gjatë shqyrtimit të këtij projektbuxheti në secilin prej komisioneve të Kuvendit, çdo propozim alternativ duhet të ketë parasysh ruajtjen e parametrave që lidhen me këta dy objektiva. Qytetarët duan rritje ekonomike dhe t'u lehtësohet masa e borxhit publik në kurriz

të sipërmarrjes dhe qytetarëve. Në vazhdimësi, ne kemi detyrën të ulim borxhin publik deri ditën kur shkon 45% e prodhimit të brendshëm bruto. Kjo është e panegociueshme për këtë maxhorancë, e cila është shumë e përgjegjshme, por edhe për secilin që ka rol aktiv ose jo të drejtpërdrejtë në këtë proces.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit!

Fjalën e ka relatori i komisionit, zoti Angjeli!

Anastas Angjeli- Faleminderit të gjithëve!

Diskutimi i projektbuxhetit, natyrisht, bëhet duke pasur në dispozicion një paraqitje të plotë dhe të dokumentuar e tij, e cila e sapo përfundoi nga ministri, natyrisht, dhe një analizë që ekspertët e komisionit dhe ne si relatorë i kemi bërë, që është vënë në dispozicion të anëtarëve të komisionit dhe anëtarëve të parlamentit. Kështu që do të përqendrohemi shkurtimisht në disa momente, pa rënë në përsëritjen e këtyre dokumenteve dhe të prezantimit që bëri ministri.

Së pari, ky diskutim bëhet në kushtet e një klime ekonomike dhe makroekonomike të financave publike, në vazhdimësi pozitive të 3-4 vjetëve të fundit, çka është një bazë shumë e shëndoshë, një bazë shumë e mirë për të pasur një buxhet që t'u shërbejë objektivave kryesorë që ka qeveria. Natyrisht, duke reflektuar dhe duke pasqyruar, në të njëjtën kohë, harmonizimin e interesave jo thjesht politikë, por të politikave ekonomike, sociale, të faktorëve të zhvillimit ekonomik, të faktorëve të interesit, natyrisht me konvergim të qytetari, i cili është përfituesi final dhe më i rëndësishëm i këtij dokumenti kryesor.

Është e natyrshme që nuk mund të ndërtohet një projektbuxhet pa u bazuar në rezultatet e këtij viti, i cili, me dokumentacionin dhe treguesit e paraqitur, tregon tendencën e tij pozitive përgjithësisht në të gjithë treguesit. Pa dyshim, kjo është një bazë e shëndoshë, siç është bazë e shëndoshë edhe harmonizimi i disa elementeve të rëndësishme që kërkon ndërtimi i një buxheti, si dhe konsiderimi i risqeve me seriozitet të madh. Kjo e bën këtë nuk mund të themi një buxhet jashtë realitetit, përkundrazi e bën një buxhet që i afrohet gjithnjë edhe më shumë realitetit të zhvillimeve dhe qëllimeve. Është e kuptueshme që një buxhet nuk mund të mos konsiderojë disa dokumente kryesore ku bazohet, siç është: strategjia e menaxhimit të financave publike, buxheti afatmesëm, kuadri makroekonomik dhe fiskal afatmesëm dhe programi i qeverisë, prioritetet që kemi caktuar në fillim të mandatit të ri qeverisës dhe, natyrisht, të gjithë kuadrin ligjor që kemi për këtë çështje. Kuptohet, në themel qëndron gjithnjë pasqyrimi ose reflektimi në shifra dhe në objektiva të rritjes ekonomike të pritshme. Kjo rritje e përkthyer në shifra, e përkthyer në drejtime dhe e përkthyer në

objektiva nuk bën gjë tjetër, veçse i jep buxhetit. Ky është një tregues, që ka ardhur gjithnjë në një progres dhe një rritje cilësore nga ata që e përgatisin projektin. Nga viti në vit duket se ky realizëm dhe ky progres shënon ngritje dhe kuptohet se e gjithë kjo reflektohet në menaxhimin më të mirë të buxhetit dhe të financave publike.

Këtu nuk mund të mos veçojmë disa çështje themelore: siç janë çështja e konsolidimit fiskal, çështja e trajtimit të borxhit publik, çështja e mbajtjes së një niveli të caktuar të investimeve publike mbi nivelin e deficitit buxhetor, natyrisht, edhe vetë një harmonizim, gjithnjë në rritje, dhe më mirë i politikës buxhetore, politikës monetare dhe politikës fiskale, si dhe zbutja e deficitit të llogarisë korrente. Nuk mund të mos konsiderojmë vlerësimet dhe sugjerimet, që janë bërë nga një periudhë në tjetrën të menaxhimit të financave publike nga institucionet ndërkombëtare dhe nga Fondi Monetar, nga Banka Botërore, nga institucionet e tjera dhe nga Komisioni European, për arsye se ne jemi një vend që tashmë e kemi përcaktuar rrugën tonë të integritit në Bashkimin European dhe është e kuptueshme që ky bashkëpunim dhe ky reflektim në përgatitjen e këtij dokumenti themelor të shtetit, është një element tjetër që është konsideruar me seriozitet, me qëllim që ky dokument t'i përgjigjet më mirë trendit të zhvillimit ekonomik të vendit tonë në këto vite, por edhe për vitet e ardhshme.

Këtu u bë një analizë e hollësishme e elementit më themelor, që është gjendja e zhvillimit ekonomik në vend dhe ecuria pozitive e saj. Pa dyshim, që të gjithë treguesit dëshmojnë se vazhdon kjo rritje ekonomike dhe pritshmëria e rritjes ekonomike për në fund të vitit pritet që të jetë me të vëretetë pozitive bazuar në elemente shumë të rëndësishme. Kjo ka bërë që tashmë Shqipëria, edhe pse me një rritje të tillë, është në vendet më të larta të rajonit. Natyrisht, ne synojmë gjithnjë dhe më të lart, sepse i dimë nevojat e qytetarëve, dimë nevojat e ekonomisë, gjithashtu dimë edhe nivelin e jetesës, por kthesa bërë është në një trajektore pozitive, që premtan të vazhdojë bazuar në elemente të rëndësishme që qeveria ka ndërmarrë dhe të reformave strukturore që janë në vazhdim.

Është e rëndësishme që kjo rritje ekonomike, të cilën e kemi diskutuar disa herë, të reflektohet dhe të përkthehen këto buxhete familjare përmes elementeve të rëndësishme, që mund të përfitojnë buxhetet familjare. Pa dyshim, një nga këto është elementi që ne kemi shënuar një kthesë të rëndësishme, që është çështja e punësimit, është reflektuar pozitivisht në tregun e punës, me uljen e papunësisë dhe me rritjen e numrit të vendeve të punës, çka është një bazë e shëndoshë edhe për buxhetin e vitit 2019, për ta avancuar akoma edhe më tej në përmirësimin e mëtejshëm të tregut të punës dhe të rritjes së vendeve të punës. Natyrisht, të gjitha këto nuk mund të arrihen pa disa kryqëzime, që bëhen midis të ardhurave dhe

shpenzimeve. Pikërisht mbi këtë bazë, mbi këto që thashë dhe që ministri prezantoi, që dokumentet e paraqitura mbartin, tashmë janë formuar dhe janë shumë të qarta disa karakteristika dhe disa objektiva kryesore të buxhetit të vitit 2019, të cilat do t'i përmend shkurtimisht.

Së pari, mbetet dhe është baza që ne kemi, me këtë buxhet do të sigurojmë një vijueshmëri të rritjes të qëndrueshme ekonomike, të stabilitetit të mëtejshëm makroekonomik dhe të konsolidimit fiskal. Pra, pritet që ekonomia, edhe pse ministri i përmendi disa risje, që në vitin 2019 të kalojë rritjen prej 4,3%, gjë që është pozitive, për t'u mbështetur më pas për 2-3 vjetët e ardhshëm. Natyrisht, kjo është bazuar në disa faktorë, (kur të arrij në fund do të them edhe sugjerimin tim) shumë pozitivë që ka ekonomia në këtë moment. Natyrisht, kjo do të reflektohet edhe nëpërmjet asaj që thashë, në përkthim në të ardhura, në shifra konkrete dhe rishpërndarjen e tyre, ku pritet që të ardhurat të kenë një rritje në krahasim me vitin 2017, duke siguruar një rritje, edhe pse të butë, në përqindje ndaj GDP-së së këtyre të ardhurave, të cilat janë një bazë e shëndoshë për të garantuar atë program të shpenzimeve që buxheti ka për vitin e ardhshëm.

Së dyti, konsolidimi fiskal mbetet një objektiv shumë i rëndësishëm. Kjo vjen për shkak të kontrollit mbi deficitin buxhetor dhe mbi bilancin primar. Deficiti buxhetor parashikohet që të jetë më i ulët se ky vit, i pritshmi i këtij viti në 1,9% nga 2%. Natyrisht, bilanci primar vazhdon të ndjekë kahun pozitiv të 4 vjetëve dhe në vitin e ardhshëm parashikohet të jetë me një suficit në nivelin 0,5% e GDP-së, gjë që janë, si të thuash, dy levat e rëndësishme. Edhe pse ne i konsiderojmë këto dy qëllime dhe objektiva, por janë instrumentet kryesor që e bëjnë buxhetin të jetë sa më eficient në zbatimin e tij gjatë vitit 2019.

Është e qartë se gjatë gjithë periudhës pas vitit 2008 deri në vitin 2013, por edhe në vazhdimësi kemi debatuar për qëndrimin që duam të mbajmë ndaj borxhit publik dhe trajektorja e borxhit publik ndjek përsëri objektivin e vazhdimin në ulje të tij edhe në vitin 2019.

Pa dyshim, ka një analizë të hollësishme të të ardhurave, të cilat mbështeten në dy shtylla kryesore, nga njëra, në vazhdimin e konsolidimit fiskal dhe, nga ana tjetër, ato do të vazhdojnë të mbështesin financimin e objektivave kryesorë të zhvillimit ekonomik dhe një pakete sociale që shoqërohet me rritjen e pagave. Natyrisht, këto janë kalkuluar mbi bazën e zbatimit më me efikasitet të politikës fiskale ekzistuese, por edhe të ndryshimeve fiskale, të cilat ne do t'i diskutojmë nesër, të politikave të reja fiskale, që qeveria ka sjellë për vazhdimin e uljes së barrës tatimore, por edhe për dhënien e incentivave kryesore, për

zhvillimin e mëtejshëm të disa sektorëve ekonomikë, ku pritet që të kemi një interes më të lartë në zhvillimin e ardhshëm ekonomik.

Besoj se të dhënat e treguara, sidomos për rritjen e normës së dividendit të fitimit apo të të ardhurave që tatohen me 13%, apo të ndonjë ndryshimi tjetër, që do të bëhet me ligjin “Për TVSH-në” apo për ligjin “Për akcizat”, të gjitha këto me efektet e tyre, pa dyshim, janë të konsiderueshme për të ruajtur atë programim që ne kemi bërë për të ardhurat.

Natyrisht, pjesa tjetër është përdorimi më me efektivitet i këtyre të ardhurave në drejtim të shpenzimeve, si dhe përmirësimi i cilësisë së shpenzimeve, gjë e cila është reflektuar në këtë buxhet, ku niveli i shpenzimeve do të arrijë në 519,4 miliardë lekë ose 29,6% e GDP-së. Kuptohet, e gjithë kjo paketë shpenzimesh do të mbështet në shpenzime për investime, si dhe në paketën e rritjes së një pakete sociale. Ajo që është e rëndësishme është se ne kemi një mbështetje të shpenzimeve për investime prej 5,1% të GDP-së, si dhe vazhdojmë të mbështesim reformat, që ka ndërmarr qeveria.

Janë një sërë reformash, unë besoj se ministri u përqendrua në ekspozenë dhe dokumenti i ka shumë të hollësishme vazhdimin e reformave, sidomos reformën në arsim, reformën në shëndetësi, reformën në bujqësi dhe reformën në infrastrukturë, të cilat vazhdojnë të konsiderohen prioritetet më themelore të ekonomisë sonë, që do t’i japin një impuls të ri zhvillimit ekonomik. Decentralizimi fiskal ka pjesën e tij, pas miratimit që i kemi bërë për të mirëfunksionuar dhe të gjitha këto përbëjnë shtyllat kryesore të objektivave kryesore të këtij buxheti.

Natyrisht, çdo , sado i përkryer të jetë, mbart me vete risqe dhe problematika, të cilat duket se janë konsideruar me shumë vëmendje në hartimin e këtij projekti dhe mbeten për t’u ndjekur me vëmendje në zbatimin e tij, me qëllim që objektivat e tij, të vendosura në projekt të jenë sa më afër realitetit. Natyrisht, kjo duhet të jetë si për të ardhurat e buxhetit të shtetit, të cilat këtë vit, krahasuar me vitin 2018, shënojnë rritjen që përmenda më lart, por që kuptohet është e domosdoshme të kenë një ndjekje të vazhdueshme nga ana e organeve fiskale në luftën kundër evazionit dhe kundër informalitetit.

Rritja e cilësisë së shpenzimeve dhe vazhdimi i ndjekjes me vëmendje për realizimin në kohë të tyre, sidomos të projekteve kryesore me impakt në ekonomi; një analizë e raportit të shpenzimeve ndaj GDP-së, në mënyrë të detajuar; personalisht, nuk jam kundër akteve normative, sepse ekonomia jonë është shumë e ndikueshme nga zhvillimet e brendshme dhe të huaja, por me qëllim që ne të kemi një ndjekje konstante të këtyre problematikave, është e kuptueshme që në këtë buxhet dhe në buxhetin afatmesëm të ndiqet me shumë rigorozitet realizmi i objektivave të vendosur, me qëllim që në çdo kohë të merren masat e nevojshme

për të arritur eficiencën maksimale të realizimit të buxhetit dhe në të jemi shumë reflektues në kohë ndaj zhvillimeve të brendshme dhe ndaj zhvillimeve të tregut evropian dhe ndikimit në ekonominë shqiptare.

Thellimi i konsolidimit fiskal mbetet shtylla e objektivit kryesor dhe mbështetja kryesore, e cila jep garanci për arritjen e treguesve që janë normuar, veçanërisht për rritjen ekonomik. Kjo do të thotë se vëmendja kryesore duhet të jetë vazhdimisht në dy elemente kryesore: në ndjekjen me kujdes dhe sistematike të realizimit të objektivave për reduktimin e defiçitit buxhetor dhe të borxhit publik, me mundësitë për të shmangur të gjitha risqet që mund të dalin përpara. Baza e gjithë buxhetit është rritja ekonomike. Këtu u përmend nga vetë ministri që duhet të konsiderojmë edhe sistemin energjetik në vend, i cili gjatë këtij viti na dha mbështetje të madhe, përveç sektorëve dhe degëve të tjera të ekonomisë. Jemi aktualisht në një vit shumë të thatë, pra një kohë që nuk favorizon pasjen e të njëjtave rezultate që pati sistemi energjetik në 6-mujorin e parë të vitit të kaluar. Kështu që duhet të kihet në konsideratë për të minimizuar të gjitha risqet që mund të shkaktojnë.

Sektorët prioritarë që u përmendën më lart, si bujqësia, arsimi, shëndetësia, infrastruktura janë sektorët ku ne fokusohemi me anë të këtij buxheti dhe kërkojnë vëmendje. Natyrisht, duke u fokusuar dhe duke u dhënë gjithë këtë kujdes, ata duhet ta reflektojnë këtë kujdes në rritje të cilësisë së shërbimeve për ata sektorë ku prevalon shërbimi, dhe në rritje të produktivitetit në ata sektorë, të cilët kanë mbështetjen kryesore, pra duhet të kenë rritje të prodhimit, zgjerim të veprimtarisë së biznesit, rritje të punësimit dhe kjo do të reflektojë në zhvillimin e ekonomisë.

Në fushën e shpenzimeve publike ne duhet të vazhdojmë të kemi vëmendjen për realizimin maksimal të shpenzimeve që programojmë për investimet. Kështu që po i rikthehem edhe një herë çështjes, sepse kjo kushtëzon pastaj edhe rritjen e ekonomisë, duke e shoqëruar me masat e tjera që marrim vazhdimisht për të rritur klasifikimin e Shqipërisë në çështjet që kanë të bëjnë me *Doing Business* dhe me lehtësitë e tjera që u kemi krijuar dhe vazhdojmë t'i krijojmë biznesit.

Thashë që në fillim se kemi një harmonizim të politikave konsoliduese fiskale me politikat lehtësuese monetare. Megjithatë, duhet të ketë një transmetim më të madh të politikës monetare në ekonomi. Në duhet të bëjmë ç'është e mundur që sistemi bankar shqiptar të jetë më prezent në ekonominë shqiptarë, sepse sa më prezent të jetë ky sektor, nëpërmjet kreditimit të sektorëve prioritarë, aq më e madhe do të jetë frymëmarrja e biznesit, aq më e madhe do të jetë frymëmarrja e ekonomisë dhe aq më i madh do të jetë zhvillimi i ekonomisë.

E përmenda çështjen e borxhit, por po i rikthehem. Një politikë e kujdesshme, siç po ndiqet, duhet të vazhdojë. Pa dyshim që ka pasur dhe vazhdon të ketë interpretime të ndryshme. Unë besoj se Ministria e Financave është në rrugën e duhur për të konfirmuar një standard të ri profesional dhe ndërkombëtar në kalkulimin dhe llogaritjen e borxhit publik, duke marrë në konsideratë edhe sugjerimet që janë bërë nga organet kontrolluese, nga KLSH-ja, me qëllim që të mos ketë ekuivokë në këtë çështje.

Gjithashtu, është e qartë që komisionet, të cilat do të diskutojnë për projektbuxhetin, do të kenë sugjerimet e tyre dhe, të dy relatorët, unë dhe Evisi, bashkë edhe me ekspertët e komisionit jemi këtu që të bëjmë më të mirën për të reflektuar që ky buxhet gjatë vitit 2019 të jetë sa më efektiv dhe më dobiprurës për ekonominë dhe për qytetarët e vendit tonë, të cilët në këtë moment i kanë kthyer sytë te ky dokument i rëndësishëm ekonomik, financiar, social dhe juridik që është i përvitshëm, por që është pasqyrë dhe reflektim i zhvillimeve të pritshme. Nisur nga gjithë ky prezantim që është bërë dhe nga komentet që ne bëjmë, pa dyshim dhe me pyetjet e diskutimet që do të bëhen, ne do të ftojmë deputetët dhe Kuvendin që pas këtij diskutimi ta miratojnë atë.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zoti Angjeli!

Dua t’ju them që komisioni, përveç kësaj seancë të parë të prezantimit në parim të projektligjit “Për buxhetin e shtetit”, ka parashikuar që nesër të marrë në shqyrtim në parim paketën fiskale, pra 7 projektligjet financiare që shoqërojnë buxhetin e shtetit. Ndërkohë, do të ketë ka seanca të posaçme për të diskutuar për të ardhurat, shpenzimet, për deficitin, për borxhin, për investimet, madje edhe me ministra të tjerë, si dhe për koncesionet. Doja ta dinit këtë, me qëllim që të orientoheni te pyetjet, në rast se do të keni, për ministrin e Financave.

Kështu, kalojmë te pyetjet. Kush ka pyetje?

Urdhëroni, zonja Kushi.

Evis Kushi – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, zoti Ministër, për prezantimin e plotë dhe të detajuar të projektbuxhetit për vitin 2019! Nuk do të ndalem shumë te vlerësimi i tij, sepse këto vlerësime i kemi shprehur në raportin e Komisionit për Ekonominë dhe Financat bashkë me profesor Anastas Angjelin, por kam një pyetje që lidhet me paktën e solidaritetit.

Në fillim të shtatorit ne miratuam rishikimin e buxhetit të vitit 2018, ku një ndër pikat kryesore ishte pikërisht paketa e solidaritetit, e cila garanton shpërblimin për pensionistët dhe për shtresat në nevojë. Me të drejtë ne atëherë theksuam që paketën e solidaritetit e kishim kthyer në një standard të ri. Kjo do të thotë se ne nuk e lidhim atë me

vitin elektoral, por e përfshijmë në buxhet me një shifër konkrete të konsoliduar. Dua të di nëse për vitin 2019 është parashikuar që në buxhet, apo do të kemi përsëri një akt normativ për të qenë konsistentë me deklaratat tona dhe me premtimet tona ndaj kësaj shtrese?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Do të jemi konsistentë me procedurën e ndjekur në vitin 2018.

Erion Braçe – A ka pyetje të tjera?

Urdhëroni!

Xhevit Bushaj – Faleminderit, ministër, për të gjithë ekspozenë që i bëtë dokumentit themeltar të shtetit shqiptar, pra të projektbuxhetit!

Unë e vlerësoj punën tuaj dhe të stafit tuaj. Vlerësoj edhe rritjen ekonomike dhe konsolidimin e të gjithë treguesve makroekonomike të paketës fiskale që ka krijuar kushte të përshtatshme për krijimin e një projektbuxheti të konsoliduar dhe faktik. Pyetja ime e parë lidhet me fondet e planifikuara për kompensimin e interesave. Konkretisht, a është menduar në buxhetin e vitit 2019 për ndonjë produkt të veçantë, siç është ai i sigurimit të bujqësisë, sepse, në dijeninë time, shoqëritë e sigurimit të bujqësisë nuk e sigurojnë bujqësinë në total, por atë aktivitet bujqësor që zhvillohet në ambientet e mbrojtura, siç janë serrat, dhe sidomos ato që janë në rrjedhat e lumenjve, gjë e cila është kthyer në një makth për fermerët e këtyre zonave dhe për sikletin që i krijohet qeverisë në momente të veçanta?

Pyetja e dytë: ishte një lajm i mirë fakti që bajpasi i Fierit do të përfundojë në sezonin turistik, ose do të jetë i kalueshëm, por nuk e di se deri ku është ecur, sepse, me sa di unë, në lumin e Semanit nuk është përfunduar ura. Si parashikohet që të jetë gati në sezonin turistik?

Erion Braçe – Zoti Bushaj, jemi për të diskutuar për buxhetin në parim. Pyetjet specifike do t'u adresohen ministrave. Të jeni i bindur se këtu do të jetë i pranishëm edhe ministri i Transportit, të cilin mund të pyesni për cilëndo rrugë dhe jo vetëm për bajpasin e Fierit. Kështu që ju lutem që me pyetjet tuaja t'u referoheni çështjeve që kanë të bëjnë me thelbin e paraqitjes së projektbuxheti, detajet u takojnë seancave të posaçme.

Xhevit Bushaj – Faleminderit!

Unë i kam shqetësime këto, prandaj i ngre si deputet, ju veproni si ta shikoni të arsyeshme, sepse do të kemi kohën e nevojshme në dispozicion për t'i parë.

Pyetja e tretë: nevojat për hua kanë ardhur duke u ulur, nga ana tjetër, shpenzimet për interesa zënë 2,4% e prodhimit të brendshëm bruto. Si shpjegohet? Mos ka ndonjë faktor të mëparshëm.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Pyetjes së parë për fondet e bujqësisë, siç ju referova, ky vit që vjen, mund të quhet kollaj fare edhe viti i bujqësisë për ato arsye që unë citova, pra mbështetja buxhetore prej 2,6 miliardësh lekësh drejtpërsëdrejti për fermerët, pjesa e dytë është IPARD-i që shkon në kombinim midis Komisionit European e buxhetit të shtetit dhe është 4 miliard lekë. Sigurisht, ne kemi edhe fondin e garancisë për kolateralet dhe interesat. Të tria këto instrumente kanë mundësi ta çojnë financimin e bujqësisë mbi 100 e ca milionë dollarë. Pra, është një kombinim midis mbështetje buxhetore, kredisë dh IPARD-it.

Për sa i përket sigurimit të prodhimit, qeveria nuk siguron prodhimin. Qeveria nuk ka shpenzime për të siguruar prodhimin e çdo fermeri. Kjo është detyrim ose zgjedhje e çdo fermeri apo çdo etniteti juridik që prodhon në bujqësi apo jo vetëm.

Për sa i përket bajpasit të Fierit, kryetari ju tha që ky është diskutimi i buxhetit në parim. Megjithatë, unë me kënaqësi po jua them ne detaje që bajpasi i Fierit do të bëhet i kalueshëm në sezon. Edhe veprat publike, veprat e artit, janë kalkuluar nga Ministria e Infrastrukturës që të bëhen dhe fokusimi do të jetë tek ato elemente që bëjnë të mundur bajpasin e Fierit të kalueshëm në fillim të sezonit.

Për sa i përket buxhetit të vitit 2019, siç e shikoni, kostoja e interesave, e shërbimit të borxhit është 2,4, në vitin 2018-të është 2,5 dhe në 2013-ën ka qenë 3,2.

Kjo do të thotë se është ulur konsiderueshëm, gati 0,8% e prodhimit të brendshëm bruto dhe vjen nga dy faktorë: e para, nga mirëmenaxhimi i borxhit, nga zgjatja e maturimit, si dhe nga balancimi i instrumenteve afatmesme dhe afatgjatë me ato afatshkurtër në favor të atyre afatmesëm dhe afatgjatë. Mos harroni që shumë shpejt pjesa e borxhit koncesional të marrë që nga '92, '93, '94, '97, '98, 2000 e kusur ka ardhur koha të paguhet. Sigurisht, me atë konsolidim fiskal që kemi ne, do të zëvendësohet me borxh. Ajo që bëjmë ne është ta zëvendësojmë me borxh të përballueshëm. Pra, kostot e borxhit janë në ulje. Ne marrim parasysh edhe risqet e mundshme. Në mos gaboj, para katër javësh, *Federal Reserve* parashikoi rikthimin në rritje të interesave me planifikim nominal për tre vjetët që do të vijnë me 0,25%, në mos gabohem. Të njëjtën gjë pritet të bëjë Banka Qendrore Europine, sepse sinjalin e ka dhënë.

Sinjali i parë që ka dhënë është tërheqja nga ndërhyrja drejtpërsëdrejti në blerjen e bonove sovraane për të ndihmuar shtetet që janë në krizë ose që kanë qenë në krizë, ashtu siç mund të jenë sot në vështirësi Italia dhe Greqia. Greqia ende nuk guxon të dalë në tregun e financimit të borxhit, por vazhdon të varet përsëri nga ndërhyrja e Bankës Qendrore Europiane.

Banka Qendrore Europiane ka dhënë sinjalin e tërheqjes deri në fund të shtatorit 30 miliardë dhe deri në fund të dhjetorit 15 miliardë, pra po shkon me reduktim. Automatikisht na takon neve që ta marrim parasysh atë që do të ndodhë në tregun ndërkombëtar, sepse tregu ndërkombëtar automatikisht do të ketë influencim në koston e borxhit. Mos harroni se jemi 47,53% ndërmjet borxhit në monedhë të huaj dhe borxhit në monedhë vendase. Kështu që besoj se kjo do të jetë edhe trajektorja.

Faleminderit!

Erion Braçe – A ka pyetje të tjera?

Po, urdhëroni zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Zoti Ministër, faleminderit për prezantimin që bëtë ju dhe stafit juaj!

Falënderoj edhe relatorin e komisionit për gjithçka parashtroi!

Ne si maxhorancë besoj se ndihemi shumë komodë në diskutimin e këtij buxheti me këto shifra, që lidhen me rritjen dhe me treguesit pozitivë. E vetmja gjë që është në ulje, e themi me kënaqësi, është papunësia dhe borxhi.

Lexoj me kënaqësi që kemi një rritje të të ardhurave prej 6,5% nga viti 2018 për të mbërritur në 28% të mbledhjes në raport me prodhimin e përgjithshëm bruto.

Pyetja ime konsiston: në këtë rritje të ardhurave sa do të zërë vend TVSH-ja ose taksa kryesore që kemi? Çfarë rritje do të ketë ajo në raport me vitin 2018?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Siç e shikoni në tabelën fiskale, që është paraqitur, TVSH-ja në vitin 2018 është afërsisht 148 miliardë lekë dhe shkon në 153 miliardë lekë. Pra, ka një shtesë gati me 5 miliardë lekë në vlerë nominale, ndërsa në vitin 2019 do të mbetet në rreth 9% të PBB-së. Mos harroni që ne kemi kapërcyer në gati dyfish të vlerës së rimbursimit për shkak të trashëgimisë të ngarkuar nga tri projekte kryesore, TAP-i, që e akumuloi TVSH-në në 5 vjet dhe duhet të paguhet në vitet 2018-2019 dhe nuk ka qenë e vogël; *Ayen Enegy*, që akumuloi për 7 vjet dhe të duhet të paguhet në vitet 2018-2019, si dhe Bankers-i, që ka akumuluar edhe për shkak të konflikteve ndër vite dhe, në fakt, është duke u ezauruar dhe duke netuar edhe pozicionin e TVSH-së së kreditueshme. Pra, TVSH-ja do të vazhdojë të jetë shtylla e të ardhurave.

Unë besoj se edhe sistemi i fiskalizimit teknologjik, gjej rastin ta ndaj me ju si deputetë dhe anëtarë të komisionit përgjegjës, nuk do të ketë asnjë kosto për biznesin, nuk do të ketë kasa të reja, pra nuk do të hiqen kasat dhe do të vihen të reja. Kjo nuk është një përrallë politike, por është një investim teknologjik në harmoni të plotë me

antiinformalitetin. Kjo do të thotë se do të bëjë të mundur që çdo biznes në kohë reale të skanojë veten, të skanojë detyrimet dhe të skanohet nga tatimet në marrëdhënie që ka me bizneset e tjera dhe me konsumatorin. Pra, nuk do të ketë asnjë kosto të re, zero kosto të re. Çdo gjë tjetër është politike dhe është bolori e zakonshme, që tani nga filozofi bolorike, ka kaluar në babalizëm.

Erion Braçe – A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Zoti Ministër kam unë tri pyetje, që lidhen drejtpërdrejtë me atë çfarë ju prezantuat dhe me atë çfarë relatoi edhe relatori i komisionit lidhur me projektbuxhetin në parim.

Pyetja e parë ka të bëjë me rritjen ekonomike.

Ju parashikoni rritjen ekonomike me 4,3% dhe, natyrisht, edhe të listimi që u bëni risqeve nga rritja ekonomike që mund t'i vijë buxhetit për vitin e ardhshëm, natyrisht kjo është e para. Unë dua të di: nga cilat degë të ekonomisë ju prisni rritje? Kur flasim për shpenzimet, a mund të na thoni: me çfarë do të financohet konsumi i popullatës?

Së dyti, në vijim gjatë gjithë këtyre vjetëve është ngritur një shqetësim, që ka të bëjë kryesisht me investimet e huaja direkte, që bëjnë pjesë të formimi të kapitalit fiks bruto. Unë dua të di: çfarë prisni ju në këtë aspekt për vitin e ardhshëm? Si do të financohet ky zë?

Së dyti, kam dy pyetje që kanë të bëjnë me financimin e kontratave koncensionare dhe PPP-të.

Natyrisht, ju shprehët këtu vullnetin tuaj që të mos lejoni pagesa që i kalojnë 5% të të ardhurave për secilën nga këto kontrata apo për koncesione të reja. Megjithatë, ju e listoni këtu përsëri si risk dhe me çfarë shikoj është i katërti në radhë nga risqet që mund t'i vijë buxhetit. Madje, këtu thuhet se në rast të tejkalimit të këtij kufiri Këshilli i Ministrave merr masa korrektuese në krahun e të ardhurave buxhetore të nevojshme dhe të mjaftueshme për t'u rikthyer brenda kufirit të lejuar të dy vjetëve të ardhshëm buxhetorë. Dua të di, pavarësisht asaj që ju thatë këtu, a mund të presim që ky nivel të tejkalohet dhe më pas të detyrohemi që t'i rishikojmë, ashtu siç ju e përshkruani në dokumentin që shoqëron projektligjin e buxhetit, në krahun e të ardhurave dhe shpenzimeve më tej?

Përsëri, në dokument ju thoni se keni rritur kapacitet monitoruese të kontratave koncensionare. Natyrisht, është një punë e mirë e bërë në këtë aspekt, por unë dua të di mënyrën se si monitorohet zbatimi i këtyre kontratave dhe mbulimet që janë angazhuar për to. Këtu nuk e kam fjalën për këto që listohen në dokumentin e buxhetit të shtetit, por për morinë e madhe të koncesioneve, që është në një tabelë tjetër, që shoqëron përsëri ligjin e buxhetit të shtetit, sidomos këto të sektorit të energjisë apo sektorit tjetër të shërbimeve, përfshirë koncesionet, që kanë lidhje të drejtpërdrejtë edhe me shërbime, që bëhen në fushën

e administrimit të të ardhurave, siç është harkimi i karburanteve, pullat fiskale apo shërbimi i kontrollit teknik të automjeteve e të tjerë me radhë?

Arben Ahmetaj – Apo skanimi, sepse zë një pjesë të konsiderueshme.

Erion Braçe - Skanimin e kemi edhe me pagesë për vitin tjetër, kështu që është buxhetore.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atë nuk e përmend njeri, sepse nuk quhet si pagesë koncesioni.

Unë jam shumë i interesuar për pjesën e koncesioneve të shërbimeve, veçanërisht në sektorin e shëndetësisë, sepse ka një kompakt të drejtpërdrejtë te njerëzit, prandaj më intereson kjo pjesë.

Pyetja e tretë ka të bëjë me detyrimet e prapambetura. A ka detyrime të prapambetura dhe të trashëguara për vitin 2018, përtej atyre të pushtetit vendor, apo të krijuara gjatë këtij viti dhe çfarë do të ndodhë me ato gjatë vitit 2019?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Pyetja e parë kishte të bënte me rritjen ekonomike dhe cilët sektorë do ta furnizojnë. Ne besojmë se rritja do të vazhdojë në aspektin e sektorëve dhe do të mbështetet nga shërbimet, si: ndërtimi, industria dhe nga bujqësia. Ju e mbani mend mirë kur ne dolëm me tezën një modeli të ri ekonomik dhe tashmë ky model ekonomik ka shifra pozitive. Këtë dua ta lidh me pyetjen tuaj për aspektin e shpenzimeve se nga do të furnizohet konsumi i popullatës.

Konsumimi i përgjithshëm i popullatës ka të paktën 13 tremujore që vjen në rritje dhe tremujori i fundit, në mos gabohem, e ka pasur diku te 3,3% rritjen e konsumit dhe është furnizuar, do ta theksoj specifikisht, nga përmirësimi i tregut të punës që është e para, sepse shifrat, siç lidhen në formulë, lidhen edhe në logjikë. Rritja ekonomie ka prodhuar punësim, punësimi ka prodhuar rritje të të ardhurave, rritja e të ardhurave ka prodhuar rritje të konsumit. Sigurisht, investimet, ajo që me të drejtë ju iu referuat formimit të kapitalit fiks bruto po ta shikosh në historikun afatshkurtër në retrospektivë kryesisht është rritur duke iu referuar përdorimit të kapitalizimit të fitimeve, sepse ende sistemi bankar është me kontribut marxhinal në veprimtarinë e saj. Besoj se do të kemi të njëjtat influenca në financimin e kapitalit fiks bruto, ndërkohë besojmë se edhe investimet e huaja do të kenë një efekt shumë të rëndësishëm në rritjen ekonomike, një efekt të drejtpërdrejtë, por edhe indirekt në aspektin e kalkulimit.

Besojmë se këtë vit investimet e huaja do të kapin një nivel rekord, duke iu referuar shifrës së 6-mujorit, e cila është 493 milionë euro.

Pyetja juaj e dytë ka të bëjë me ...

Erion Braçe – A mundem të them diçka lidhur me pyetjen e parë?

Arben Ahmetaj – Po, ju lutem!

Erion Braçe - Unë nuk pyeta më kot lidhur me punën e degëve të ekonomisë, nga të cilat ju prisni rritje. Unë iu referova të dhënave të 3-mujorit të dytë të vitit 2018, sepse 3-mujori i tretë nuk ka dalë ende, natyrisht në këto 4 degë për të cilat ju folët, shërbimet, ndërtimi, industria dhe bujqësia, tre prej tyre ose kanë rritje minimale ose në 3-mujorin e dytë kanë performuar në rënie, sidomos ndërtimi dhe industria. Kështu që prandaj pyeta se çfarë parashikoni më tej, me qëllim që të mos kemi të papritura. Veçanërisht gjatë 3-mujorit të dytë pothuajse të rritja 4,32% kemi një rritje të energjisë me 2,37 pikë përqindje.

Arben Ahmetaj – Atëherë, sa për t'ju sqaruar, zoti kryetar, bujqësia nuk ka pasur rritje negative, por e ka pasur...

Erion Braçe – E ka pasur 0,29%.

Arben Ahmetaj – Jo, kontributin e ka pasur 0,29%, por ky është kontributi në rritje, kurse rritjen e saj e ka...

Erion Braçe – E ka pasur 1,56%.

Arben Ahmetaj – Më falni, zoti kryetar!

Kontributi në rritje në 4,3% e ka pasur 0,29% dhe para dy vjetëve e ka pasur negative, kurse rritjen e saj e ka pasur 1,72% , pra është rikthyer në rritje. Industria, po ta shikosh, ka një kontribut të konsiderueshëm me 2,37% dhe rritjen brenda vetes e ka 20,51%. Lidhur me ndërtimin, ky 3-mujor në 3 vjetët e fundit është i vetmi që e ka kontributin dhe rritjen negative për shkak të natyrës së vetë 3-mujorit, që ka të bëjë me efektin gati-gati minimal të investimeve publike, sepse akoma nuk kishin filluar punët publike. Ndërkohë që do ta shohim në tremujorin e tretë dhe të katërt ku ndërtimi do të ketë efekte pozitive, por edhe gjatë vitit që vjen për shkak të punëve të mëdha publike që do të jenë në vazhdim.

Po t'i referohemi tregtisë me pakicë dhe me shumicë, si aktivitet ekonomik, kontributi shkon 0.82% dhe rritja shkon 4,7%, gjithmonë pozitive. Përveç informacionit dhe telekomunikacionit, i cili për hir të së vërtetës për një periudhë shumë të gjatë që ka rritje dhe kontribut negativ, e gjithë pjesa tjetër, pra siç e theksova bujqësia, industria, ndërtimi dhe shërbimet, pra tregtia me pakicë dhe shumicë kanë rritje pozitive.

Në bujqësi, kryetar, çështja nuk është më financimi, sepse e vërteta është që financimi në bujqësi është rritur konsiderueshëm. Sfida e bujqësisë është produktiviteti dhe korrektimi i bazës ekonomike. Nuk ka rritje me ngastra. Bujqësia nuk mund të japë atë që kërkojmë ne nga ngastrat e vogla me nga një dhe dy dynym, por duhet të krijohet një

ekonomi shkalle, po e flas në zhargon që të ketë duk para e hedhur dhe ku të përdoret teknologjia dhe makineria. Është sektori më i mbështetur, si me paketë fiskale, ashtu edhe me financim.

Unë besoj se sfida e bujqësisë, e institucioneve që merren me bujqësinë dhe e Ministrisë së Bujqësisë është korrektimi i atyre problematikave që kanë të bëjnë me produktivitetin në bujqësi, mbi të gjitha me ekonominë e shkallës dhe me inovacionin në bujqësi. Me instrumentet tradicionale dhe me ngastra të vogla bujqësia nuk do të kthejë mbrapsht atë që duam ne dhe atë që ëndërrojnë ata që merren me bujqësi, edhe po të hidhen shumë para.

Për sa i përket partneritetit publik privat, me të drejtë ju i drejtoheni monitorimit. Ne, si Ministri e Financave, nuk monitorojmë kontratat, por i monitoron autoriteti kontraktor ose ministria e linjës. Detyra e Ministrisë së Financave është monitorimi i riskut fiskal dhe jo i kontratave. Kjo është e drejtpërdrejtë. Brenda Ministrisë së Financave ka dy njësi, e para është njësia e monitorimit, që është brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, dhe departamenti tjetër është ai i koncesioneve që merret me *value for money* apo me vlerën për njësi para të një koncesioni apo të një partneriteti publik privat.

Nuk është e rastësishme kur themi që nuk do të kalojë 5%, sepse ne e planifikojmë afatmesëm dhe afatgjatë. Është vlerë ta ndaj me ju atë ndryshimin e ligjit që Ministria e Financave dhe Ekonomisë me mbështetje dhe me urdhër të Kryeministrit ka avancuar, sepse në fushën e transportit nuk do të ketë më koncesione me ofertë të pakërkuar, duke filluar që nga 1 korriku i vitit 2019, pra po bëjmë një ndryshim të ligjit, i cili bën një kuadrim më të mirë të procedurës për t'iu referuar edhe risqeve fiskale.

Ne planifikojmë afatmesëm dhe siç e shikoni nuk e kalojmë asnjëherë 5%. Ajo që ne kemi shkruar, i është referuar mot a mot ligjit organik të menaxhimit të sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ku theksohet se, nëse Shqipëria do ta kalojë 5% atëherë qeveria është e detyruar të marrë masa jo vetëm nëpërmjet të ardhurave, por edhe nëpërmjet shpenzimeve.

Të ilustroj një shembull: nëse në x vit do të kalonte 5% të të ardhurave totale të vitit paraardhës, atëherë qeveria do të korrektonte menjëherë pagesën e drejtpërdrejtë duke reduktuar shpenzimet e tjera brenda kuadrit makro. Kjo gjë e detyron qeverinë të bëhet më shumë e përgjegjshme. Megjithatë, në reference të asaj që thatë, me planifikimin afatmesëm dhe afatgjatë ne shkojmë deri në vitet 2025 dhe 2028, si Ministri e Financave në planifikimin e PPP-ve.

Ju iu referuat vetëm PPP-ve të shëndetësisë, ndërsa unë po ju them që skanimi ka shkuar në 1.9 miliardë. Qytetarët e Shqipërisë paguanjnë 1.19 milionë dollarë për skanimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po flas për buxhetin e shtetit, nuk po flas për sipërmarrjen. Buxheti i shtetit paguan 19 milionë dollarë, sipërmarrja paguan një pjesë tjetër goxha të konsiderueshme.

Për rrugën e hidrocentralit të Banjës, që nuk e përmend njeri, kush pagoi 52 milionë euro? Edhe kjo pagesë koncesioni është.

Te shërbimet e shëndetësisë, nuk i referohen thelbit të partneriteteve. Thelbi i partneritetit është dializa, i cili është shërbim që duhet të paguhet nga buxheti i shtetit. Çfarë, do të komercializojmë dializën? Dikur e paguanin 8 mijë lekë dhe nuk shërbehej as gjysma e tyre që shërbehen sot, por përsëri shërbehej me një pikë.

Patjetër që ka risqet e veta që duhen monitoruar nga ana buxhetore dhe fiskale dhe këtë po e bëjmë në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë.

E njëjta gjë vlen edhe për sterilizimin. Asnjë nuk i referohet objektit të kësaj PPP-je, ulja e infeksioneve në operacione apo në shërbimet spitalore. Pra e gjithë boloria shkon te PPP-ja. Patjetër që gjithsecili ka të drejtë të monitorojë si qytetar, si institucion dhe si politikan partneritetin publik privat, por asnjë nuk i referohet uljes së infeksioneve të marra në operacion. Pra referenca e jetës njerëzore është zero. Numri është ulur me mbi 20% dhe vazhdon të ulet vetëm për shkak të sterilizimit.

Check up-i, asnjë nuk i referohet shpëtimit të jetëve apo parandalimit të avancimit të sëmundjeve, pra referenca e jetëve të njerëzve është zero.

A kanë për t'u përmirësuar të gjitha procedurat e monitorimit? Patjetër. Prandaj e thashë që ne e kemi parashikuar të mos kalojë 5%, për të pasur një *buffer*.

Për sa u përket detyrimeve të prapambetura, kryetar, është kusht që të shlyhen deri në fund të vitit nga kursimet ose asnjë ministri nuk lihet të hapë asnjë projekt të ri pa paguar detyrimet e prapambetura. Krijimi i detyrimeve të prapambetura, si ritëm është ulur konsiderueshëm. Por ka ministri që akumulojnë detyrime të prapambetura dhe ne si Ministri e Financave i detyrojmë t'i shlyejnë detyrimet e prapambetura në fund të vitit ose në faturën e janarit dhe të shkurtit dhe nuk i lëmë të hapin projekte të reja pa paguar akumulimet e prapambetura. Kjo është betejë e rëndësishme me ministrinë e linjës, mos akumulimi i detyrimeve të prapambetura.

Për hir të së vërtetës, pushteti vendor i ka reduktuar, por ky nuk ishte objekti i pyetjes tuaj. Por edhe TVSH-ja e tre projekteve që unë u jam referuar, ka një skedul që në shtator – nëntor të vitit 2019 ezaurohet komplet.

Në mirëmbajtjen e rrugëve, për shkak të avancimit të kontratave, para dy vjetëve ka një krijim të detyrime të prapambetura me 1.6 miliardë, të cilat do të shlyhen këtë vit, brenda limitit që kanë.

Nuk e di nëse iu përgjigja pyetjeve që bëtë, por besoj që detyrimet e prapambetura ishte pyetja e fundit.

Erion Braçe – Sa janë në total detyrimet e prapambetura deri në fund të tetorit?

Arben Ahmetaj – Deri në fund të tetorit detyrimet janë rreth 2.4 miliardë të trashëguara dhe 1.6 miliardë të akumuluar, që do të shlyhen brenda limiti buxhetor të këtij viti.

Erion Braçe – Faleminderit!

Dua të shtoj diçka pas përgjigjeve nga ana juaj, natyrisht që e mirëpresim ligjin e ri për koncesionet dhe partneritetin publik privat, por kjo kërkon që deri në miratimin e këtij ligji, që ju thatë që do të jetë në qershorin e vitit të ardhshëm...

(Ndërhyje pa mikrofon.)

Efekti i tij do të jetë në datën 1 korrik 2019, do t'ju luteshim që të bëhet kujdesi maksimal i mundshëm për kontratat e reja që ju keni parashikuar në këtë hark kohor, deri në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit, për kostot e tyre dhe natyrisht edhe për cilësinë e kontratave.

A ka pyetje të tjera?

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Në kushtet kur ministri do të jetë prezent për të prezantuar shpenzimet dhe buxhetin për vitin 2019, mendoj që pyetjet mund të jenë pjesë e takimeve dhe e zhvillimeve që do të kemi në ditët në vazhdim.

Erion Braçe – Nuk ka ndonjë gjë tjetër?

Dakord, zoti Ministër kemi një kërkesë që të kishim tabelat fiskale që nga viti 1996 e këtej, duke përfshirë edhe të pritshmin e këtij viti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po ju kërkoj një tabelë fiskale të integruar së bashku me të pritshmin e këtij viti dhe natyrisht projeksionet për vitet 2020 – 2021 – 2022.

Arben Ahmetaj – Dua të bëj një sqarim, kryetar, patjetër që tabelat do të jenë që nga viti 1996, por i pritshmi i fundit do të jetë gati në javët në vijim...

Erion Braçe – Këtë të tetorit që keni ju.

Arben Ahmetaj – Nuk e kemi bërë të pritshëm akoma, besoj se do të jetë gati në javët në vazhdim, duke parë të ardhurat, ecjen e investimeve, por edhe paketën sociale, sepse

kjo paketë ka një tendencë që në fund të vitit avancon më shumë se të tjerat. Megjithatë, një parashikim të të ardhurave e keni edhe te faqja 10 e relacionit, gjithsesi do të jemi në komunikim me njëri-tjetrin.

Erion Braçe – Faleminderit!

Kjo pjesë e parë e mbledhjes mbyllet këtu.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.11.2018, ora 12:30

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2017, për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive rurale””.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Ilir Xhakolli, Xhevit Bushaj, Arben Pëllumbi, Reme Lala, Ervin Bushati dhe Roland Xhelilaj.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Ilir Halilaj – Zëvendësministër i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Pjerin Shoshi - Drejtor i Programeve të Zhvillimit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural

Edlira Llango - Drejtore juridike

Elma Vathi – Shefe në Sektorin e Kordinimit dhe Integritetit.

Brikena Jazxhi –Specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Erion Braçe – Vazhdojmë me marrëveshjen.

Kemi për të prezantuar dhe diskutuar projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2017, për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive rurale””.

Për të prezantuar projektligjin ndodhet në Komisionin e Ekonomisë, Ilir Halilaj, zëvendësministër i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Fjala është për ju.

Relator për këtë projektligj është zoti Ervin Bushati.

Ilir Halilaj – Përshëndetje!

I nderuar kryetar i komisionit,

Të nderuar anëtarë,

Jemi këtu për të kërkuar mbështetjen tuaj për miratimin në parim të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive rurale”.

Duhet theksuar që kjo marrëveshje është një fond-grant prej 5 milionë eurosh, që do të shërbejë si kapital për të garantuar kreditimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, në sektorët e bujqësisë, blegtorisë dhe agropërpunimit, për kreditimin e mëtejshëm të këtij sektori.

Jemi nisur nga një eksperiencë e mirë 3-vjeçare me financimin e parë prej 3 milionë eurosh të këtij fondi. Ky fond ka rezultuar në rreth 1100 kredi të disbursuara deri në qershor të 2017-s dhe ka krijuar një lehtësi në likuiditetin e shtuar të kapitalit të vënë në dispozicion të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në bujqësi.

Së bashku me kolegët, jemi këtu për ta detajuar më tej këtë marrëveshje me çdo pyetje që mund të keni, si dhe për të marrë mirëkuptimin tuja për miratimin e saj.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Bushati!

Ervin Bushati – Faleminderit!

Kjo është një marrëveshje shumë e rëndësishme.

Përfitoj nga rasti të falënderoj edhe një herë qeverinë gjermane për fondet që ka dhënë në vazhdimësi, për promovimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, përmes fondit të garancisë së kredive rurale, me një vlerë prej 5 milionë eurosh, për përmbushjen e

objektivitet të inkurajimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme mbi një masë të qëndrueshme, duke garantuar kreditë tregtare të institucioneve mikrofinanciare, të cilat do t'u ofrojnë kredi kredimarrësve në segmentin bujqësor e rural të ekonomisë, që ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e konkurrueshmërisë së tyre dhe krijimin e vendeve të reja të punës në bujqësi!

Marrëveshja ka interes, si në aspektin ekonomik, edhe në atë social, duke marrë në konsideratë nevojën për mbështetjen financiare dhe shtysat e mëtejshme në fushën e promovimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Kushtet, të cilat vihen në dispozicion të marrëveshjes, si dhe procedura e dhënies së porosisë, përcaktohen në kontratën që do të lidhet ndërmjet KfW-së dhe marrëses së shumës së financimit dhe u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e kësaj marrëveshjeje janë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Fondi Rural i Garancisë së Kredive.

Meqenëse ky projektligj është në përputhje me programin e qeverisë për zhvillimin ekonomik të sektorit të bujqësisë, ftoj të gjithë kolegët ta miratojnë atë.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit!

Ka pyetje. Nuk ka.

Ka diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në votimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2017, për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive rurale”””.

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 1.

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

E hedhim në votim në tërësi projektligjin.

Kush është kundër? Nuk ka. Pro? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji.

Faleminderit!

Jeni të lirë të largoheni.

MBYLLET MBLEDHJA